



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 05 dhe 06

Prishtinë, më 1.11.2017 dhe 6.11.2017, në ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhjen e dt.1.11.2017 morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivkoviç, Valon Ramadani, Fisnik Ismaili, Imet Rrahmani, Xhevahire Izmaçu, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, OSBE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit, me këtë

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 27.10.2017;**
- 3. Diskutim lidhur me nismën legjislative për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Para miratimit të rendit të ditës, me kërkesën e nënkryetares së komisionit, znj. Shqipe Pantina, kërkoi nga komisioni votimin për shkarkimin e anëtares së Bordit të RTK-së, pasi komisioni kishte shqyrtuar në njërin nga mbledhjet e kaluara çështjen e lartcekur.

Lidhur me këtë, komisioni votoi me 6 vota për dhe një abstenim, Nait Hasani, për shkarkimin e anëtares së Bordit të RTK-së dhe nxori këtë

R e k o m a n d i m:

I. I Rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë shkarkimin e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Mimoza Hasani – Pllana.

II. Arsytimin e Rekomandimit e paraqet, Shqipe Pantina, zëvendëskryetare e Komisionit.

Arsyetim

Komisioni, në bazë të nenit 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, ka iniciuar procedurën për shkarkimin e anëtares së Bordit të RTK-së.

Shkarkimi i anëtarit të Bordit të RTK-së, bëhet kur anëtari i RTK-së, i cili mban post publik të zgjedhur dhe të emëruar, është i/e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit, konform nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, të përcaktuar me ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Komisioni, në dy mbledhje ka diskutuar lidhur me shkeljet e anëtares së Bordit të RTK-së, e cila është emëruar nga Kuvendi i Kosovës, më datë 30 korrik 2015, me mandat 3 vjeçar.

Gjatë ushtrimit të funksionit si anëtare e Bordit, në të njëjtën kohë ka ushtruar detyrën e nëpunësit civil, zyrtare për të drejtat e fëmijëve në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe këtë pozitë nuk e ka pezulluar konform nenit 89, paragrafi 1, pika 3 të Ligjit për shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin e datës 20 korrik 2017, nr.103/2017, ka rekomanduar Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të zbatojë rekomandimet e Këshillit, në afat prej 15 ditësh.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nuk ka zbatuar rekomandimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit prej 15 ditësh, të përcaktuar me Vendimin e Këshillit, por për të njëjtin rast ka marrë vendim, më datë 12 tetor 2017, nr.2.3443.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 1 nëntor 2017, me 6 vota për dhe 1 abstenim, vendosi t'i rekomandojë Kuvendit shkarkimin e anëtares së Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, pasi e njëjta me veprimet e saj ka shkelur ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 28, paragrafi 2, pika 2.2 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës: “Kuvendi i Kosovës, me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarit të RTK-së.”

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 27.10.2017

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me nismën legislative për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kryetari i komisionit, njoftoi pjesëmarrësit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, për procedurat e nismës legislative të komisionit, konform rregullave të Rregullores së Kuvendit, pastaj ua dha fjalën pjesëmarrësve të Këshillit, për të prezantuar se a kanë ndonjë propozim, sugjerim apo vërejtje lidhur me ndryshimin e ligjit.

Shkëmb Manaj, kryetar i Këshillit, propozoi ndryshimet për çështjet si vijon:

- mandati i tyre të zgjatet nga 5 në 7 vite, me pamundësi rizgjedhjeje;
- sanksionimi për eprorët e institucioneve, të cilët nuk i zbatojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, në raport me shërbimin civil të Kosovës, zgjerimi i kompetencave të Këshillit, por edhe i përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit;
- heqjen e përkufizimeve nga teksti i ligjit, pasi që ato janë të përcaktuara me Ligjin për shërbimin civil, si dhe
- për emërimin e një anëtari në Këshill, kandidati duhet të ketë të dhënë provimin e jurisprudencës.

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës ndryshimet të hartohen me shkrim.

Mbledhja përfundoi në orën:12:30.

Në mbledhjen e dt.6.11.2017, morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Munguan: Jasmina Zhivkoviç, Fisnik Ismaili, Arban Abrashi dhe Imet Rrahmani,.

Në mbledhje morën pjesë: përfaqësues të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit, me këtë

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim lidhur me nismën legislative për hartimin e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

Përmbledhje e diskutimit për fillimin e nismës për Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Komisioni diskutoi dhe shqyrtoi propozimet lidhur me:

- mungesën e anëtarëve të Këshillit nga puna për arsyet që nuk parashihen me ligj, për të cilën çështje u propozua të hartohet një nen që do të harmonizohet konform ligjit të punës;
- kompetencat e Këshillit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe shqyrtimi i ankesës dhe vendosja nga një anëtar, përderisa me ligjin aktual ankesat shqyrtohen nga kolegji;
- shkurtimi i afateve për shqyrtim të ankesave;
- llogaritja e afateve nga institucionet për zbatim të vendimeve;
- sanksionet për institucionet që nuk i zbatojnë vendimet e Këshillit;
- dorëzimi i ankesave nga palët, në formë elektronike;
- monitorimi i institucioneve nga Këshilli lidhur me zbatimin e Ligjit për shërbimin civil;
- nxjerrja e akteve nënligjore në afat prej tre muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit;
- si kusht për emërim në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të jetë provimi i jurisprudencës.

Konstatim: Komisioni kërkoi nga përfaqësuesit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë, që të hartojnë propozim- ndryshimet, lidhur me çështjet e sipërsënuara dhe t'i adresojnë me shkrim në komision.

Mbledhja përfundoi në orën:13:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani